



KUVENDI  
NR 2580/ DATE 05.07.24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË  
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE  
INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

Nr 2693 Prot.  
!

Tiranë më, 2.7.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Z. Fatmir XHAFAJ ✓  
KRYETAR  
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR  
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr. 4

TIRANË

*Inderuar Z. Xhafaj !*

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 2580 prot., datë 28.6.2024, ardhur dhe protokolluar më datë 1.7.2024, me lëndë "Ftesë për bashkëpunim", ju bëjmë me dije se:

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka trajtuar me përparësi dhe në tërësi kërkesën e paraqitur prej Jush, duke vlerësuar qëllimin e iniciativës në drejtim të përbashjes së detyrimeve në kuadër të proceseve reformuese dhe integruese në Bashkimin Evropian.

Inspektorati i Lartë, duke theksuar mbështetjen e vazhdueshme që Kuvendi i Shqipërisë i ka dhënë institucionit ndër vite, si në drejtim të forcimit të kuadrit ligjor, ashtu edhe në drejtim të rritjes së burimeve njerëzore e financiare, shpreh angazhimin për të bashkëpunuar në kuadër të përbashjes së objektivave të përbashkët për sundimin e ligjit dhe luftën kundër korruptionit.

Për sa më sipër, Inspektorati i Lartë cakton si përfaqësues të tij, për të marrë pjesë në grupet e ekspertëve:

- 1- Arbër Basholli me adresë kontakti [abasholli@ildkpk.al](mailto:abasholli@ildkpk.al)
- 2- Adela Tagani me adresë kontakti [atagani@ildkpli.al](mailto:atagani@ildkpli.al)
- 3- Majlinda Thomaj me adresë kontakti [mthomaj@ildkpli.al](mailto:mthomaj@ildkpli.al)

Në lidhje me kërkesën tuaj, mbi paraqitjen e të dhënave dhe dokumentave të hartuar nga institucioni, Inspektorati i Lartë, në përbushje të parashikimeve ligjore të nenit 39, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*”, i ndryshuar, në bazë vjetore ka hartuar Raportet e veprimtarisë, të cilët përbajnë tregues të plotë të aktivitetit të institucionit, në fushat përkatëse të kompetencës.

Në këtë drejtim, Raportet Vjetore përbajnë një analizë të plotë të përbushjes së rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë adresuar institucionit, realizimin e reformave të lidhura me procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, ushtrimin e kompetencave ligjore, për kontrollin e interesave privatë të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, në funksion të evidentimit, shmangies e parandalimit të konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, si dhe të monitorimit të sinjalizimeve.

Për më tepër, në Raportet Vjetore gjejnë pasqyrim prioritetet dhe sfidat për çdo vit pasardhës raportues, duke qenë dokumenta me të dhëna të vlefshme për procesin e analizimit dhe hartimit të një strategjie, për forcimin e mëtejshëm të institucionit.

Inspektorati i Lartë ka raportuar dhe është monitoruar nga partnerët kryesorë ndërkombëtarë, si Komisioni Evropian dhe/ose Këshilli i Evropës, me qëllim adresimin e rekomandimeve të tyre, në drejtim të procesit të integrimit Evropian.

Në këtë kuadër, si Komisioni Evropian në Raportet për Shqipërinë, ashtu edhe Këshilli i Evropës me instrumentin e GRECO, kanë vlerësuar progresin e vazhdueshëm të Inspektoratit të Lartë, në drejtim të përbushjes së kompetencave ligjore dhe rritjes së kapaciteteve institucionale.

Megjithatë, Inspektorati i Lartë mbetet i angazhuar për të pasur prioritet të punës, përbushjen e rekomandimeve të dala nga Raporti i Shqyrimit Analistik për Shqipërinë, të publikuar nga Komisioni Evropian në korrik të vitit 2023, gjetjet dhe rekomandimet e të cilit, u finalizuan me miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës, nëpërmjet VKM nr. 736, datë 13.12.2023, “*Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës*”.

Për sa më sipër, Ju dërgojmë bashkëlidhur, në formë shkresore dhe elektronike, dokumentat e hartuar nga Inspektorati i Lartë me të dhëna të nevojshme për procesin e nisur nga Komisioni i Posaçëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

INSPEKTORI PËRGJITHSHËM

Evgjeni BASHARI

